# DËSHMI ARKIVI

**A-455495**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | "Do thoni në djall ato që fituam", Rama paralajmëron supermarketet, kërkon transparencë për çmimet (VIDEO) |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/sociale/do-thoni-ne-djall-ato-qe-fituam-rama-paralajmeron-supermarketet-kerkon-t-i586902` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 14:24:26 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 14:20:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `60e11339347c07c313d54d34b68682de2c3ea88c3d105f960c15bbb1a6d07131` |
| TEKSTI | `6e7c83510ff0e53bbcb7dc79516a08a9f96afd87726eeed876b0524eabae0720` |
| PAMJA | `10ad16be5eacd1ffb4f7ce414c23b67447796a99c795692f27ae66a987b26765` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `8b357bbc334f865b3053eaceb3c1a6e76349900f4cb7a6403b8bb68a2ca87ed9` |
| E MËPARSHMJA | `057f32fa9526c608388a051ec53ff2c977c7c9318f2a9642c6ef85c268853e18` |
| RRËNJA MERKLE | `0f7613a812b8a42978251c1471689408cbc054af17ff19ea88699c02ceb99882` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/8b357bbc334f865b3053eaceb3c1a6e76349900f4cb7a6403b8bb68a2ca87ed9`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

English

Te fundit Ra ky mort e gjyqtaret po mesojne rrogat e tyreZgjedhjet ne Serbi, OSBE e gatshme te mbledhe votat ne Kosove, por pret miratimin e institucioneve vendaseTrajneri Foda

# "Do thoni në djall ato që fituam", Rama paralajmëron supermarketet, kërkon transparencë për çmimet (VIDEO)

TemA

18 Shtator 2026, 16:20Sociale TEMA




Kryeministri Edi Rama ka zhvilluar një takim me përfaqësues të supermarketeve dhe furnitorëve kryesorë në vend, për të ndezur së shpejti "Pasqyrën e Çmimeve", një platformë e re digjitale për transparencën e çmimeve.

Rama u bëri thirrje rrjeteve të supermarketeve që të angazhohen në një fazë pilot për transmetimin e të dhënave, duke propozuar që lista e produkteve të përfshijë barkodin, gramaturën dhe njësinë matëse, në mënyrë që produktet të jenë të krahasueshme mes rrjeteve.

Kryeministri theksoi se platforma duhet të pasqyrojë çmimin final për konsumatorin, përfshirë TVSH-në, si dhe të bëjë dallimin mes çmimit normal dhe atij promocional.

"*Unë besoj se ju jeni të vetëdijshëm se po fitoni më shumë nga ç'e mban zakoni i mirë në një bashkësi si e jona që s'është as Kina, as Amerika, dhe ku ky kapitalizmi agresiv ka filluar të bëhet shqetësues për të gjithë. Të angazhohemi bashkërisht, konkretisht, që të rrjeti i pikave tuaja të shitjes të marrin pjesë në një fazë pilot dhe të nis transmetimi i të dhënave. Të dorëzohet lista e produkteve që përputhet me kategorinë e kësaj faze, me barkod, me gramaturë, me njësi matëse, në mënyrë që të produktet të jenë të krahasueshme mes gjithë rrjeteve. Platforma për të marrë çmimin real final për konsumatorin, me TVSH, dhe të dallojë çmimin normal nga promocioni dhe periudha e vlefshmërisë. Qytetari të shikojë, të krahasojë, edhe të zgjedhë, jo të jetë në errësirë dhe të përballet me çfarë i sjell rruga në errësirë, dhe mos ketë një pasqyrë konkurrence, ku më i shkathëti dhe më i shpejti të fitojë më shumë. Askush s'po ju thotë që ne të përcaktojmë çmimet se do ishte marrëzi. Askush s'po ju thotë të mos nxirrni fitime. Por ka ardhur një moment që ta shohim njëri-tjetrin në sy. Por që të ngarkoni njerëzit ne s'do t'ua lejojmë, do jetë problem i madh, do thoni çfarë i hapëm vetes, në djall ato që po i fitojmë pa të drejtë*".



## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Shqipëri–Slloveni, rritet bashkëpunimi ekonomik - Turizmi malor dhe përpunimi i drurit në fokus të diskutimeve për investime dhe partneritete të reja

16:10 Sociale

Kontroll agjencive funerale në Tiranë, masa për reklamat dhe ekspozimin në zonat e banuara

15:50 Sociale / 1 koment

Ilirjan Celibashi kërcënon me mesazhe gazetaren Desada Metaj, reagon AGSH

15:06 Sociale / 8 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.